



Kanton Zürich
Bildungsdirektion
Volksschulamt
Pädagogisches, Lehrplan 21

Kontakt: Projekt Lehrplan 21, Projektleitung, Walchestrasse 21, 8090 Zürich
Telefon 043 259 22 99, lehrplan21@vsa.zh.ch

Albanisch

Bisedat me prindërit dhe dëftesa. Kopshti i fëmijëve dhe klasa e 1-rë/2-të e ciklit fillor (cikli i parë)

Informacione për prindërit dhe të autorizuarit për edukim

Mësimdhënia, të mësuarit dhe vlerësimi

Në vitet e para të shkollimit mësimi orientohet kryesisht në zhvillimin e fëmijëve. Loja luan një rol të rëndësishëm dhe është pjesë e rëndësishme e mësimit. Gjatë kopshtit të fëmijëve dhe në vitet e para të shkollës fillore fëmijët mësojnë në masë të madhe nga detyrat e dhëna paraprakisht dhe nga referatat.

Në mësimin e suksesshëm, mësimdhënia, të mësuarit dhe vlerësimi janë ngushtë të lidhura mes vete. Bazën e kësaj e përbëjnë plani mësimor dhe mjetet mësimore. Duke u nisur nga kjo mësimdhënësit caktojnë qëllimet mësimore për një mësim të larmishëm dhe me faza sistematike të të mësuarit. Mësimdhënësit i nxisin dhe i përkrahin nxënëset dhe nxënësit në formimin e kompetencave të tyre në rrugë të ndryshme. Gjatë procesit të të mësuarit ata ofrojnë përcjellje të ndryshme; ata ju japin nxënësve dhe nxënësve vlerësime mbi zhvillimin e tyre mësimor, mbi rezultatet dhe mbi sjelljen. Në rend të parë qëndrojnë vlerësimet mbi anët e forta të secilit nxënës. Këto vlerësime janë konstruktive dhe motivuese. Ato paraqesin njëkohësisht edhe bazën e të mësuarit të mëtejshëm. Mësimdhënësit provojnë herë pas here arritjen e kompetencave dhe të qëllimeve të synuara mësimore: për shembull duke soditur procesin e lojës, në bazë të provimeve të bëra dhe të bisedave.

Bisedat me prindërit dhe dëftesa

Në kopshtin e fëmijëve dhe në klasën e parë të shkollës fillore nuk jepen ende dëftesa me nota. Nga klasa e dytë e shkollës fillore nxënëset dhe nxënësin marrin dëftesë me nota.

Kopshti i fëmijëve dhe klasa e 1-rë e shkollës fillore.

Në kopshtin e fëmijëve dhe në klasën e 1-rë të shkollës fillore mbahen dy biseda në vit me prindërit apo të autorizuarin për edukim (zakonisht nga një bisedë në



gjysmëvit). Aty bisedohet për gjendjen në mësim dhe për zhvillimin e fëmijës. Për përcaktimin e terminit të bisedës përgjegjës është mësimdhënësi. Bisedat mbahen vetëm nëse konsiderohen të domosdoshme nga mësimdhënësi dhe nga prindi.

Në kopshtin e fëmijëve prindërit kanë mundësi të heqin dorë nga biseda e dytë. Kusht për këtë është që me këtë të pajtohet edhe personeli mësimor.

Ekziston edhe një formular i dëftesës. Me nënshkrimin e formularit prindërit dëshmojnë se biseda është mbajtur apo se heqin dorë nga biseda e dytë. Formularët ruhen në një dosje. Kjo dosje ju jepet prindërve në fund të kopshtit apo të klasës së parë. Si dëshmi të përmbushjes së obligimit shkollor, formularët arkivohen në administratën shkollore.

Klasa e 2-të e shkollës fillore

Në klasën e 2-të të shkollës fillore personeli mësimor në fund të vitit shkollor bën edhe dhënien e dëftesave me nota. Bazën e saj e përbën vlerësimi i përhershëm gjatë përditshmërisë mësimore. Në klasën e dytë nota jepen vetëm për gjermanisht dhe matematikë. Në gjermanisht në fund të vitit shkollor vlerësohen këto kompetenca: të dëgjuarit, leximi, të folurit dhe të shkruarit.

Nëse për arsye të veçanta vlerësimi nuk është i mundur, hiqet dorë nga ai.

Notat nga 6 deri në 1 paraqesin rezultatet e përgjithshme në një nga lëndët. Ato shprehin se në çfarë mase një nxënëse apo një nxënës ka arritur të zotërojë qëllimet e parashtruara mësimore. Nota në dëftesë bazohet në matjen profesionale të mësimdhënësit. Nota nuk është mesatarja e rezultateve të provimeve me shkrim. Mësimdhënësja apo mësimdhënësi gjatë vlerësimit mbështetet në burime të ndryshme, si për shembull në: provimet me gojë dhe me shkrim, punimet e nxënësve, referatat, soditjet si dhe nga përfundimet që nxirren nga dialogët në mësim dhe nga bisedat.

Notat në dëftesë definoohen si vijon:



Nota	6	5	4	3	2 dhe 1
	shumë mirë	mirë	mjaftueshëm	pamjaftueshëm	(shumë) dobët
Kriteri	Nxënësja apo nxënësi				
Arritja e qëllimeve mësimore	Arrin qëllimet e vështira mësimore në shumicën e kompetencave me siguri	Arrin qëllimet në të gjitha fushat e kompetencave dhe pjesërisht edhe qëllimet e vështira mësimore	Arrin qëllimet bazë mësimore në pothuajse të gjitha fushat e kompetencave	Nuk i arrin qëllimet bazë mësimore në shumë prej fushave të kompetencave	Nuk i arrin qëllimet bazë mësimore në shumicën e fushave të kompetencave
Zgjidhja e detyrave	Zgjidh kryesisht me sukses detyrat e vështirësisë së shkallës së lartë	Zgjidh pjesërisht me sukses detyrat e vështirësisë së shkallës së lartë	Zgjidh mjaftueshëm detyrat e nivelit bazë	Zgjidh jo mjaftueshëm detyrat e nivelit bazë	Nuk zgjidh detyrat e nivelit bazë

Ka edhe aspekte që nuk janë pjesë përbërëse e notës së një lënde, si për shembull: zelli i jashtëzakonshëm apo i mangët, bashkëpunimi aktiv në mësim apo jo interesimi, puna me kujdes apo e pasaktë, korrektësia apo jo korrektësia. Këto rezultate shënohen në faqen e dytë të dëftesës në rubrikën “qëndrimi ndaj punës dhe të mësuarit” si dhe “qëndrimi social”.

Formulari i dëftesës

Dëftesat e ndryshme vendosen në një dosje dëftesash. Këto ruhen nga mësuesi përgjegjës i klasës. Në rast të ndërrimit të shkollës apo në fund të ciklit fillor kjo dosje dëftesash i jepet nxënëses apo nxënësit.

Vlerësimi i qëndrimit ndaj punës apo të mësuarit si dhe i qëndrimit social bëhet në katër kategorizime. Vlerësimet në shtyllën e dytë (mirë) i përgjigjen rasteve të rëndomta: www.volksschulamt.zh.ch > Schulbetrieb & Unterricht > Zeugnisse & Absenzen